

VENDIM
Nr. 126, datë 29.7.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST
SHA DHE FURNIZUESIT**

Në mbështetje të nenit 16, të seksionit IV, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij, të datës 29.7.2016, pasi shqyrtoi relacionin e përga-titur nga drejtoritë teknike të ERE-s, për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti